



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 707/4 prot.,

Datë 25.03.2024

V E N D I M

Nr. 301/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për miratimin e “Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për Operatorët Ekonomik”.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, vendimit nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, urdhrit nr. 36, datë 26.01.2024, me nr. 194 prot., datë 26.01.2024, të Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, “Për krijimin e grupit të punës në kuadër të hartimit të Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për Operatorët Ekonomik”, si dhe “Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për autoritetet/entet kontraktore”.

Në kuadër të hartimit të Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për Operatorët Ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik:

I Vëren

I.1. Me qëllim shmangien e gabimeve procedurale nga ana e operatorëve ekonomik në kuadër të paraqitjes së ankesës mbi një procedurë prokurimi, ka lindur nevoja për hartimin e “Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për Operatorët Ekonomik”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas vlerësimit të relacionit të paraqitur nga grupi i punës i ngritur sipas Urdhrit nr. 36, datë 26.01.2024, me nr. 194 prot., datë 26.01.2024, të Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, “Për krijimin e grupit të punës në kuadër të hartimit të Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për Operatorët Ekonomik”, si dhe “Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik për autoritetet/entet kontraktore”,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Manualit mbi ankimin administrativ për procedurat e prokurimit publik, për Operatorët Ekonomik”.
2. Publikimin e manualit në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Anëtar

Anëtar

Fiorent Zguro

Anila Malaj

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonida Myzyri

